



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Glllogoc
Zyra e Personelit
01Nr. 111-01-34254 dt. 20.06 /2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Glllogoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për pozitën : Zyrtar për Shërbime Sociale 2

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Glllogoc
Nr. i konkursit:	RN00005077
Pozita e punës:	Zyrtar për Shërbime Sociale 2
Institucioni:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
Divizioni/njësia:	Sektori për Shërbime Sociale
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtor i Drejtorisë në Komunë
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 9, Koeficienti 7.5
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 9, Koeficienti 7.5, Qendra për Punë Sociale, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore:

1. Ofron shërbime në mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, birësim, strehim;
2. Bën mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikvente;
3. Ndihmon rastet e abuzimit dhe lënies pas dore të fëmijëve;
4. Punon në sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe familjare;
5. Trajton rastet e dhunës në familje dhe rastet e trafikimit me qenie njerëzore;
6. Punon në mbrojtjen e të moshuarve dhe bën mbrojtjen e tyre dhe strehim;
7. Mban kujdestarinë 24 orë sipas orarit të caktuar nga organi i kujdestarisë së QPS-së ;
8. Mban dosjet e lëndëve dhe dokumentacionin, si dhe futja e lëndëve në bazën e të dhënave;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor,(aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës):

Diplomë universitare , 2 vite përvojë pune profesionale;

Fakulteti Filozofik- Drejtimi Sociologji, Psikologji, Punëtor Social, Fakulteti Juridik

Njohje kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin;

Aftësia për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion;

Njohuri dhe përvojë substanciale në lëminë e shërbimeve sociale;

Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose një grup punues;

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.
Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.
Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, çertifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kriterëve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazette të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data 20/06/2019 deri më 04/07/2019, për pozitën e cekur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes web faqes së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.



U.D. Udhëheqëse e Personelit


Hajrime Shabani